



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 05, dt. 13.03.2019

Mbi përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Qarkut për vitin 2019 si kontribut financiar në aktivitetin “Balzaku dhe personazhet e tij” organizuar nga gjimnazet “Raqi Qirinxi” dhe “Themistokli Gërmenji”

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjin Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. “Për Buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit të vitit 2019, në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 13 date 11.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2019”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratoje përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Qarkut për vitin 2019 në vlerë 150 mijë lekë si kontribut financiar në aktivitetin “Balzaku dhe personazhet e tij” organizuar nga gjimnazet “Raqi Qirinxi” dhe “Themistokli Gërmenji” në kuadër të vitit të Balzakut.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances, Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimeve në Këshillin e Qarkut.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi L.Pleqi
Juristi Gj.Kristo
Sek.K.Qarkut B. Muço

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I QARKUT KORÇE

Drejtoria e Finances, Zhvillimit Ekonomik dhe Sherbimeve

Relacion

Mbi përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Qarkut për vitin 2019 si kontribut financiar në aktivitetin “Balzaku dhe personazhet e tij” organizuar nga gjimnazet

“Raqi Qirinchi” dhe “Themistokli Germezi”

Ne kuader të vitit të Balzakut gjimnazet e qytetit “Raqi Qirinchi” dhe “Themistokli Germezi” në bashkëpunim me njëri tjetrin po punojnë për organizimin e aktivitetit “Balzaku dhe personazhet e tij”. Te dy gjimnazet kanë paraqitur një kopje të draft projektit dhe kërkojnë mbështetje financiare nga Keshilli i Qarkut.

Qëllimi i këtij aktiviteti është:

- Vendi që ze Balzaku në letërsinë dhe kulturën botërore.
- Ndikimi që ka pasur tek lexuesit shqiptarë.
- Veprat e tij janë pjesë e programeve të letërsisë për shkollat e mesme.
- Viti 2019 është përcaktuar si “Viti i Balzakut”

Aktiviteti është konceptuar në formën e një prezantimi skenik të personazheve dhe situatave të romaneve të Balzakut. Qëllimi i këtij aktiviteti, ku do të marrin pjesë aktore-nxenes, është të nxjerrin në pah tipare karakteristike të kohës, mentalitetit dhe njerezve.

Për realizimin e këtij aktiviteti grupi organizator ka parashikuar një sërë shpenzimesh si

- Shpenzime për skenën teatrale, ndricim, fonia, materiale skenike, kostume për aktoret – nxenes si dhe role figurantesh.
- Postera, ftesa, afishe dhe materiale promovuese, realizimi i spoteve promovuese etj.
- Ture në shkollat e rajonit për të promovuar si model punën dhe frymëzimin punës të nxenesve dhe bashkëpunimin midis shkollave.

Për realizimin e këtij aktiviteti nga ana e dy gjimnazeve është kërkuar mbështetje financiare në vlerë 150 mijë leke.

Per sa me sipër, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjin Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin “Për Buxhetin e vitit 2019”, në Udhezimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit të vitit 2019, në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 13 date 11.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2019”, i propozojmë Këshillit të Qarkut miratimin për përdorimin e fondit rezerve të Këshillit të Qarkut për vitin 2019, në vlerë 150 mijë leke, si mbështetje financiare për aktivitetin “Balzaku dhe personazhet e tij” organizuar në kuadër të vitit të Balzakut.

Liljana Pleqi

Drejtoreshë e Financës



Korce, më 11.03.2019